



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.37

Prishtinë, më 9.12.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Mufera Shinik, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të OSBE-së, KDI-së, NDI-së, Zyra e Presidentes dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.12.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.12.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 2.12.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Nait Hasani, tha se Komisioni gjatë shqyrtimit të projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ka mbajtur disa mbledhje, ka organizuar dëgjim publik dhe ka zhvilluar debate me partnerët, me qëllim të diskutimit dhe përfshirjes së të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me Akademinë. Sipas Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional, pas marrjes së raporteve me rekomandime nga komisionet e përhershme, mbledhet për të shqyrtuar këtë raport, dhe më pas, ky raport me rekomandime procedohet për lexim të dytë. Komisionet e përhershme: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, konstatoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm; Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka konstatuar se amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë; Komisioni për Integritet Evropian ka konstatuar se amendamentet e propozuara dhe projektligji nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian; dhe Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, ka konstatuar se amendamentet e propozuara nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Janë ngritur shqetësime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me informimin apo raportimin për punën e Akademisë, që një herë në vit të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë, tha se nuk sheh ndonjë pengesë apo ndërhyrje në punën e Akademisë, në rast të informimit, duke pasur parasysh se buxheti i Akademisë miratohet në Kuvend. Ndërsa, sa i përket çështjes së ushtrimit të funksioneve udhëheqëse, kemi konsideruar që zvogëlimi i moshës nga 75 në 70 vjeçare, është bërë me qëllim të rinimit të Akademisë.

Ai tha se ASHAK do të duhej të deklarohej për çështjet politike në vend dhe për krizën politike, gjë e cila nuk është pranuar nga Akademia, me arsyetimin se ata nuk merren me politika ditore.

Salih Morina, në diskutimin e tij, tha se gjatë fazës së shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për Akademinë, kemi punuar së bashku me MASHT-in dhe me Akademinë, me qëllim që të miratohet një ligj, i cili do t'i shërbejë për të mirë punës së Akademisë.

Ai ngrii shqetësimin në dy amendamente, njëri që i referohet nenit 2, paragrafi 4, ku thuhet : ''4. Akademia për punën e vet një herë në vit e informon Kuvendin e Republikës së Kosovës'', si dhe tjetra, që i referohet nenit 16, paragrafi 5, ku thuhet : ''5. Anëtarët e Akademisë mbi moshën 70 vjeçare nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse'', për të cilat tha se janë bërë pa miratimin e anëtarëve të Komisionit. Ai kërkoi që këto dy nene të mos procedohen, të shqyrtohen përsëri në Komision, në mënyrë që t'i dërgohet raport Kryesisë dhe propozoi të fshihen.

Bekim Haxhiu, tha se si Komision kemi pasur debate të ndryshme, dhe lidhur me këtë, konsideron se Akademia si institucion promovon hulumtimin dhe zhvillimin e shkencës dhe ajo duhet të jetë larg politikës. Sa i përket çështjes së raportimit, ai tha se Akademia do të duhej të jetë shembull për llogaridhënie për punën dhe financat, ndërsa sa i përket çështjes së ngritur për zvogëlimin e moshës, theksoi se duhet të kemi një rinim të moshës së akademikëve, në mënyrë që të kemi një punë më efikase.

Shpejtim Bulliqi, në diskutimin e tij, tha se Akademia do të duhej të luajë rolin e vet në çështjet që janë me interes madhor për vendin. Sa i përket çështjeve të ngritura lidhur me informimin e Akademisë në Kuvend, tha se nuk ka njohuri si ka qenë e rregulluar kjo çështje me ligjin e vjetër, por nuk shoh gjë të keqe nëse ata e informojnë Kuvendin për punën e vet, sepse nuk ka çështje sekrete, ndërsa sa i përket çështjes së zvogëlimit të moshës, tha se me këtë jemi pajtuar që të rinohet Akademia dhe besoj se këtë e dëshirojmë të gjithë, por në fund të fundit, për këto dy çështje, le të vendosin deputetët në lexim të dytë, në seancë plenare.

Nait Hasani, tha se çështja e raportimit apo informimit nuk e dëmton Akademinë. Kjo parashihet edhe me ligjin në fuqi dhe me ligjet e shteteve të ndryshme me përvojë në llogaridhënie, si Shqipëria, ku Akademia i raporton Këshillit të Ministrave, në Kroaci Akademia i raporton Parlamentit, në Britani, Akademia për punën e vet, një herë në vit, i raporton Qeverisë.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, me tre vota për dhe dy kundër, Komisioni vendoi që ta procedojë për lexim të dytë Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Përgatitur nga: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani